

LIGJI NR. 08/L-150

PËR RATIFIKIMIN E TRAKTATIT MBI NDIHMËN E NDËRSJELLË JURIDIKE NË ÇËSHTJET PENALE NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE KONFEDERATËS ZVICERANE

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR RATIFIKIMIN E TRAKTATIT MBI NDIHMËN E NDËRSJELLË JURIDIKE NË ÇËSHTJET PENALE NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE KONFEDERATËS ZVICERANE

**Neni 1
Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim të ratifikojë Traktatin ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Konfederatës Zvicerane për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Çështjet Penale, të nënshkruar nga Ministrija e Drejtësisë e Republikës së Kosovës dhe Ambasadori Zviceran në Prishtinë, më 5 prill 2022, në Prishtinë.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Ky ligj vlen për të gjitha organet e administratës shtetërore dhe organet gjyqësore në Kosovë që janë përgjegjëse për bashkëpunim juridik ndërkombëtar.

**Neni 3
Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 08/L-150
21 korrik 2022**

Shpallur me dekretin Nr. DL-258/2022, datë 08.08.2022 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu

*Tabelat e Ligjit nr. 08/L-150 "Për Ratifikimin e mbi ndihmën e ndërsjellë juridike në çështjet penale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Konfederatës Zvicerane" bashkangjitur me ligj janë publikuar në web faqen e Gazetës Zyrtare (gzk.rks-gov.net)

TRAKTAT

MBI NDIHMËN E NDËRSJELLË
JURIDIKE NË ÇËSHTJET
PENALE

NDËRMJET

REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

KONFEDERATËS ZVICERANE

Republika e Kosovës

dhe

Konfederata Zvicerane

Më poshtë të referuara si "Palët Kontraktuese",

DUKE PASUR PARASYSH miqësinë dhe bashkëpunimin që i bashkon;

DUKE DITUR se luftimi i krimit ndërkufitar është përgjegjësi e përbashkët e komunitetit ndërkombëtar;

TË VETËDIJSHËM se forcimi i bashkëpunimit juridik, sidomos i ndihmës së ndërsjellë juridike, është i domosdoshëm për të shmangur rritjen e aktiviteteve kriminale;

DUKE DËSHIRUAR që t'i ofrojnë njëra-tjetrës masën më të gjerë të ndihmës së ndërsjellë juridike për të luftuar krimin dhe për të ngritur efektivitetin e bashkëpunimit në hetimin, ndjekjen dhe ndëshkimin e krimit;

NË PËRPUTHJE me kushtetutat, ligjet dhe rregullat përkatëse, si dhe parimet e së drejtës ndërkombëtare, e në veçanti sovranitetit, integritetit territorial, mosndërhyrjes dhe sundimit të ligjit;

DUKE RESPEKTUAR parimet e vendosura në konventat përkatëse ndërkombëtare, posaçërisht në fushën e të drejtave të njeriut;

Janë pajtuar si vijon:

KAPITULLI I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Obligimi për të ofruar ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet penale

Palët Kontraktuese marrin përsipër t'i ofrojnë njëra-tjetrës, në përputhje me dispozitat e këtij Traktati, masën më të gjerë të ndihmës së ndërsjellë juridike në çështjet penale në të gjitha hetimet, ndjekjet penale ose procedurat për veprat penale, ndëshkimi i të cilave, në kohën e paraqitjes së kërkesës për ndihmë, bie në juridiksionin e autoriteteve gjyqësore të Palës Kërkuese.

Neni 2

Fushëveprimi i ndihmës

1. Ndihma përfshin masat si vijon, të ndërmarra me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të procedurës penale në Palën Kërkuese:
 - a) marrjen e dëshmive ose deklaratave tjera;
 - b) dërgimin e sendeve, dokumenteve, të dhënave dhe provave;
 - c) dorëzimin e sendeve dhe pasurisë me qëllim të konfiskimit ose kthimit;
 - d) shkëmbimin e informatave;
 - e) kontrollimin e personave dhe të pasurisë;
 - f) lokalizimin dhe identifikimin e personave dhe pronës, përfshirë ekzaminimin e sendeve dhe vendngjarjeve;
 - g) gjurmimin, ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave dhe instrumenteve të krimit;
 - h) shërbimin e dokumenteve;
 - i) transferimin e personave të ndaluar me qëllim të marrjes në pyetje ose ballafaqimit;
 - j) të ftuarit e dëshmitarëve dhe ekspertëve për t'u paraqitur dhe për të dëshmuar në Palën Kërkuese;
 - k) çdo masë tjetër që është në përputhje me objektivat e këtij Traktati dhe mund të pranohet nga Palët Kontraktuese, me kusht që nuk është në kundërshtim me ligjin e Palës së Kërkuar.
2. Ndihma e ndërsjellë nuk duhet të refuzohet vetëm mbi bazën se lidhet me veprime për të cilat një person juridik mund të mbahet përgjegjës në territorin e Palës Kërkuese.
3. Palët Kontraktuese i ofrojnë njëra-tjetrës masën më të gjerë të ndihmës së ndërsjellë juridike në çështjet penale sa u përket shkeljeve fiskale, në pajtim me ligjet e tyre të brendshme përkatëse.
4. Ky Traktat zbatohet edhe për kërkesat për ndihmë të ndërsjellë juridike lidhur me veprime ose mosveprime të kryera përpara hyrjes në fuqi të tij.

Neni 3 Përjashtimet

Ky Traktat nuk zbatohet për çështjet si vijon:

- a) lokalizimin, arrestimin ose ndalimin e një personi të ndjekur penalisht ose të dënuar për një vepër penale me qëllim të ekstradimit;
- b) ekzekutimin e dënimeve penale;
- c) transferimin e personave të dënuar me qëllim të vuajtjes së dënimit.

Neni 4 Shkaqet për refuzimin apo shtyrjen e ofrimit të ndihmës

1. Ndihma e ndërsjellë juridike në çështjet penale mund të refuzohet nëse:
 - a) kërkesa ndërlidhet me një vepër që Pala e Kërkuar e konsideron vepër penale politike apo vepër penale që ndërlidhet me vepër politike;
 - b) kërkesa ndërlidhet me një vepër të dënueshme sipas ligjit penal ushtarak që nuk është vepër penale sipas ligjit të zakonshëm penal;
 - c) Pala e Kërkuar konsideron se ekzekutimi i kërkesës mund të cenojë sovranitetin, sigurinë, rendin publik ose interesa të tjera thelbësore të shtetit;
 - d) kërkesa ndërlidhet me fakte, në bazën e të cilave një person i ndjekur penalisht është liruar me vendim të formës së prerë, është falur ose është dënuar në Palën e Kërkuar për një vepër të ngjashme në thelb, me kusht që dënimi i shqiptuar është duke u mbajtur ose është mbajtur tashmë;
 - e) ka arsye për të besuar se kërkesa për ndihmë është paraqitur me qëllim të ndjekjes penale ose dënimit të një personi për shkak të racës, gjinisë, religjionit, kombësisë, përkatësisë etnike apo bindjeve politike ose nëse miratimi i kërkesës do ta përkeqësonte gjendjen e atij personi për cilëndo prej këtyre arsyeve;
 - f) ka arsye serioze për të besuar se procedura penale kundër personit të ndjekur penalisht nuk është në përputhje me garancitë e përmbajtura në instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, siç janë Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike e 16 dhjetorit 1966 dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut e 4 nëntorit 1950;
 - g) vepra penale për të cilën është bërë kërkesa është e dënueshme në Palën Kërkuese me një lloj të dënimit që ndalohet sipas ligjit të Palës së Kërkuar;
 - h) kërkesa për ndihmë është në kundërshtim me ligjin e brendshëm të Palës së Kërkuar, apo nuk është në përputhje me dispozitat e këtij traktati.
2. Pala e Kërkuar mund ta shtyjë ekzekutimin e kërkesës për ndihmë të ndërsjellë juridike nëse ekzekutimi i kërkesës do të ndërhynte në procedurën penale në zhvillim e sipër në Palën e Kërkuar.

3. Para refuzimit ose shtyrjes së ofrimit të ndihmës së ndërsjellë juridike sipas këtij neni, Pala e Kërkuar:
 - a) njofton menjëherë Palën Kërkuese rreth arsyeve për të cilat është duke e shqyrtuar refuzimin ose shtyrjen e ofrimit të ndihmës; dhe
 - b) shqyrton nëse ndihma mund të ofrohet pjesërisht ose të ofrohet mbi kushtet që i mendon të nevojshme. Në rastin e tillë, Pala Kërkuese duhet t'ju përmbahet atyre kushteve.

KAPITULLI II – KËRKESAT PËR NDIHMË TË NDËRSJELLË JURIDIKE

Neni 5 Ligji i zbatueshëm

1. Kërkesa ekzekutohet në përputhje me ligjin e Palës së Kërkuar.
2. Nëse Pala Kërkuese dëshiron zbatimin e një procedure të veçantë për ekzekutimin e një kërkesë për ndihmë të ndërsjellë juridike, këtë duhet ta kërkojë shprehimisht dhe Pala e Kërkuar mund ta pranojë, nëse ligji i vet nuk e ndalon këtë.

Neni 6 Kriminaliteti i dyfishtë dhe masat e detyrueshme

1. Ekzekutimi i një kërkesë që përfshin masa të detyrueshme mund të refuzohet nëse veprimi i supozuar që përshkruhet në kërkesë nuk përbën vepër penale të dënueshme sipas ligjit të Palës së Kërkuar.
2. Nëse gjatë vlerësimit, veprimi i supozuar përbën vepër penale sipas ligjeve të të dyja Palëve Kontraktuese, është e parëndësishme nëse ligjet e të dyja Palëve Kontraktuese, e klasifikojnë veprimin e supozuar në kategorinë e njëjtë të veprave penale, ose nëse e emërtojnë atë vepër penale me të njëjtën terminologji. Faktet e përshkruara në kërkesë duhet t'u përgjigjen elementeve objektive të një veprë penale të dënueshme sipas ligjit të Palës së Kërkuar.
3. Masat e detyrueshme përfshijnë:
 - a) kontrollimin e personave dhe të pasurisë;
 - b) sekuestrimin e provave, përfshirë instrumentet e përdorura për kryerjen e veprës penale;
 - c) sekuestrimin dhe konfiskimin e sendeve dhe pasurisë që përbëjnë produkte të veprës penale;

- d) çdo masë që ka për qëllim zbulimin e sekreteve të mbrojtura sipas ligjit penal të Palës së Kërkuar; dhe
- e) çdo masë tjetër që përfshin detyrim sipas ligjit procedural të Palës së Kërkuar.

Neni 7

Masat e përkohshme

1. Mbi bazën e kërkesës shprehimore të Palës Kërkuese, autoriteti kompetent i Palës së Kërkuar urdhëron menjëherë masa të përkohshme për të ruajtur situatën ekzistuese, për të mbrojtur interesin juridik të cenuar, ose për të mbrojtur provat që rrezikohen, nëse procedura e përshtatshme sipas ligjit të Palës së Kërkuar. Masat e përkohshme mund të jepen pjesërisht ose nën kushte të caktuara.
2. Nëse çfarëdo vonese do ta rrezikonte procedurën dhe nëse ka informata të mjaftueshme për të vlerësuar përmbushjen e kushteve, Pala e Kërkuar mund t'i urdhërojë këto masa, sapo të shpallet një kërkesë. Këto masa shfuqizohen nëse Pala Kërkuese nuk e parashtron kërkesën brenda afatit të përcaktuar.

Neni 8

Kufizimi i përdorimit të informatave, dokumenteve dhe sendeve

1. Palës Kërkuese nuk i lejohej t'i përdorë informatat ose provat e siguruar sipas këtij Traktati për qëllime tjera përveç atyre që janë deklaruar në kërkesë, pa pëlqimin paraprak të Autoritetit Qendror të Palës së Kërkuar.
2. Pëlqimi nuk është i nevojshëm nëse:
 - a) faktet, që përbëjnë bazën e kërkesës, përbëjnë një tjetër vepër penale për të cilën ndihma e ndërsjellë juridike do të lejohej; ose
 - b) procedura e huaj penale zhvillohet ndaj personave të tjerë që kanë marrë pjesë në kryerjen e veprës penale; ose
 - c) materialet përdoren për një hetim ose procedurë lidhur me kompensimin e dëmeve që ndërlidhen me një procedurë për të cilën është dhënë ndihma.

Neni 9

Konfidencialiteti

Secila Palë Kontraktuese i zbaton dispozitat lidhur me konfidencialitetin siç parashihen në ligjin e vet të brendshëm.

Neni 10
Të dhënat personale

1. Të dhënat personale të dërguara sipas këtij Traktati lejohen të përdoren vetëm për qëllimet për të cilat të dhënat janë dërguar dhe sipas kushteve që Shteti dërgues përcakton. Sipas përjashtimeve nga neni 8, paragrafi 2, nënparagrafët a-c, kërkohet pëlqimi paraprak i Shtetit që dërgon të dhënat për përdorim të tyre për qëllime të tjera.
2. Dispozitat si vijon zbatohen për dërgimin dhe përdorimin e të dhënave personale të dërguara për qëllime të një kërkesë për ndihmë sipas këtij Traktati:
 - a) Vetëm të dhënat që ndërlidhen me kërkesën dërgohen tek autoriteti kompetent i Palës Kërkuese.
 - b) Sipas kërkesës, Pala Kontraktuese që ka pranuar të dhënat, informon Shtetin dërgues rreth përdorimit të tyre dhe rezultateve të arritura nga përdorimi i tyre.
 - c) Nëse Shteti dërgues konsideron se janë dërguar të dhëna të pasakta, ose janë dërguar të dhëna që nuk do të duhej të dërgoheshin, Shteti dërgues njofton pa vonesë Shtetin që i ka pranuar ato të dhëna; Shteti që i ka pranuar të dhënat duhet menjëherë të përmirësojë çfarëdo gabimi ose të shkatërrojë të dhënat.
 - d) Palët Kontraktuese mbajnë shënime në një formë lehtësisht të qasshme lidhur me dërgimin dhe pranimin e të dhënave.
 - e) Dërgimi i mëtejshëm i të dhënave personale lejohet vetëm nëse është në përputhje me ligjin e brendshëm dhe me pëlqimin paraprak të Shtetit dërgues.
 - f) Të dhënat e dërguara që nuk përdoren më për qëllimet e lejuara sipas këtij Traktati, duhet të shkatërrohen pa vonesë, ose duhet të ndërmerren masa të tjera të lejuara sipas ligjit të brendshëm, që i shërbejnë në mënyrë të njëjtë të drejtës së personit të prekur.
3. Palët Kontraktuese mbrojnë të dhënat personale nga humbja aksidentale, shkatërrimi ose modifikimi aksidental ose i paautorizuar, qasja, përdorimi i paautorizuar, ose zbulimi i paautorizuar ose ndonjë keqpërdorim tjetër i tyre.
4. Palët Kontraktuese i garantojnë të drejtat legjitime personit të prekur nga dërgimi i të dhënave sipas këtij Traktati në lidhje me informatat ose qasjen në të dhënat lidhur me të, përmirësimin ose fshirjen e të dhënave të tilla, ose kufizimin e përpunimit të tyre në rastet e përshtatshme, si dhe mjete efektive juridike sipas kërkesës së personit në fjalë, në lidhje me dërgimin ose përdorimin e informatave.

5. Secila Palë Kontraktuese mund t'ia kufizojë plotësisht ose pjesërisht personit në fjalë të drejtat lidhur me informatat dhe qasjen në të dhëna, përfshirë informatat në lidhje me refuzimin për përmirësimin ose fshirjen e të dhënave personale ose kufizimin e përpunimit, nëse kjo përbën masë të nevojshme dhe proporcionale për të marrë parasysh interesat legjitime në mënyrë që të mbrohet siguria publike dhe kombëtare, të mbrohen të drejtat dhe liritë e të tjerëve, për të shmangur ndërhyrjen me kërkimet ligjore, hetimet ose procedurat, ose për të mos paragjykuar parandalimin, zbulimin, hetimin ose ndjekjen penale, ose ekzekutimin e dënimeve.

KAPITULLI III – VEPRIMET E NDIHMËS SË NDËRSJELLË JURIDIKE

Neni 11

Prania e personave pjesëmarrës në procedurë

Sipas kërkesës shprehimore të Palës Kërkuese, Autoriteti Qendror i Palës së Kërkuar, deklaron datën dhe vendin e ekzekutimit të kërkesës. Zyrtarët dhe personat e përfshirë mund të jenë të pranishëm me pëlqimin Pala e Kërkuar.

Neni 12

Marrja në pyetje e dëshmitarëve në Palën e Kërkuar

1. Marrja në pyetje e dëshmitarëve bëhet në përputhje me ligjin e Palës së Kërkuar. Megjithatë, ata mund të refuzojnë të dëshmojnë nëse ligji i Palës Kërkuese ua lejon këtë.
2. Nëse refuzimi i tyre për të dëshmuar bazohet në ligjin e Palës Kërkuese, Pala e Kërkuar ia dërgon Palës Kërkuese çështjen për vendimmarrje. Vendimi duhet të arsyetohet.
3. Dëshmitari që shfrytëzon të drejtën për të refuzuar të dëshmojë, nuk mund të jetë subjekt i asnjë dënimi në Palën Kërkuese për atë arsye.

Neni 13

Paraqitja e dëshmitarëve ose ekspertëve në Palën Kërkuese

1. Nëse Pala Kërkuese e konsideron të nevojshme paraqitjen personale të një dëshmitari ose eksperti para autoriteteve të saj gjyqësore, këtë duhet ta theksojë në kërkesën për shërbimin e fletëthirrjes dhe Pala e Kërkuar fton dëshmitarin ose ekspertin të paraqitet në territorin e Palës Kërkuese.

2. Pala e Kërkuar ia komunikon pa vonesë Palës Kërkuese me shkrim vendimin e dëshmitarit ose ekspertit lidhur me ftesën.
3. Mëditjet, shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit paguhen nga Pala Kërkuese.
4. Dëshmitarët ose ekspertët njoftohen mbi shumën e mëditjeve, shpenzimeve të udhëtimit dhe qëndrimit që u takojnë dhe mund t'i kërkojnë Palës Kërkuese paradhënie për këto mëditje, shpenzime të udhëtimit dhe të qëndrimit. Mëditjet, shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit llogariten sipas vendbanimit të dëshmitarit ose ekspertit dhe shprehen me tarifa që të paktën përkrijnë me tarifën dhe rregullat në fuqi në shtetin në të cilin do të zhvillohet dëgjimi.

Neni 14 Mosparaqitja

Dëshmitari ose eksperti që nuk i përgjigjet një ftese për t'u paraqitur, shërbimi i së cilës është kërkuar, nuk lejohet t'i nënshtrohet asnjë ndëshkimi ose mase të detyrueshme, as atëherë kur thirrja përmban njoftim për gjobë, përveç në rastet kur ai ose ajo më vonë hyn vullnetarisht në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese dhe ftohen sërish në mënyrë të rregullt.

Neni 15 Kalimi i lirë

1. Dëshmitari ose eksperti që ftohet dhe paraqitet para organeve gjyqësore të Palës Kërkuese, pavarësisht shtetësisë, nuk do të ndiqet penalisht, të ndalohet ose t'i nënshtrohet asnjë forme të kufizimit të lirisë personale në territorin e atij Shteti në lidhje me vepra penale të kryera para largimit nga territori i Palës së Kërkuar.
2. Pavarësisht shtetësisë, një person që është ftuar për t'u paraqitur para organeve gjyqësore të Palës Kërkuese për t'u përgjigjur për veprime që janë objekt i procedurës kundër tij apo saj, nuk do të ndiqet penalisht, të ndalohet ose t'i nënshtrohet asnjë forme të kufizimit të lirisë personale për veprime ose dënime nga para largimit nga territori i Palës së Kërkuar dhe që nuk janë theksuar në fletëthirrje.
3. Pa pëlqimin e tij ose saj me shkrim, një personi, për të cilin zbatohen paragrafët 1 ose 2, nuk mund t'i kërkojë të dëshmojë në kuadër të një procedure tjetër, përveç asaj me të cilin ka të bëjë kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike.
4. Imuniteti sipas këtij neni do të pushojë kur dëshmitari, eksperti ose i pandehuri që ka pasur mundësinë të largohet nga territori i Palës Kërkuese, nuk është larguar brenda periudhës prej pesëmbëdhjetë ditësh prej kur prania e tij apo

saj nuk ka qenë më e kërkuar nga autoritetet gjyqësore, ose nëse ai ose ajo pasi që është larguar nga territori i Palës Kërkuese, është kthyer përsëri.

5. Personi që pranon të paraqitet në përputhje me nenin 13 ose nenin 17, nuk lejohet të ndiqet penalisht për dëshminë e dhënë, me përjashtim të dhënies së dëshmisë së rrejshme.

Neni 16

Shtrirja e dëshmisë në Palën Kërkuese

1. Personi i ftuar përmes Palës së Kërkuar që paraqitet për të dhënë dëshmi në Palën Kërkuese, mund të detyrohet të dëshmojë ose të ofrojë prova, përveç nëse sipas ligjit të njëres nga Palët Kontraktuese ka të drejtë ta refuzojë këtë.
2. Nëse refuzimi për të dëshmuar ose kundërshtimi për të ofruar prova mbështetet në ligjin e Palës së Kërkuar, Pala Kërkuese ia dërgon Palës së Kërkuar çështjen për vendimmarrje. Vendimi duhet të arsyetohet. Dëshmitari që shfrytëzon të drejtën për të refuzuar të dëshmojë, nuk mund të jetë subjekt i asnjë dënimi në Palën Kërkuese për atë arsye. Parimi i specialitetit sipas nenit 8 zbatohet përshtatshëm.

Neni 17

Transferimi i përkohshëm i personave të ndaluar

1. Personi në paraburgim, paraqitja personalisht si dëshmitar apo me qëllim të ballafaqimit e të cilit kërkohet nga Pala Kërkuese, transferohet përkohësisht në vendin ku do të zhvillohet shqyrtimi, me kusht që ai ose ajo të rikthehet në territorin e Palës së Kërkuar brenda afatit të caktuar nga kjo Palë dhe në përputhje me dispozitat e nenit 14 të këtij Traktati, për aq sa janë të zbatueshme.
2. Transferimi mund të refuzohet në qoftë se:
 - a) personi i ndaluar nuk pajtohet;
 - b) prezenca e tij ose saj është e nevojshme në një procedurë penale në zhvillim në territorin e Palës së Kërkuar;
 - c) transferimi do të mund t'i zgjaste kohën e paraburgimit; ose
 - d) ekzistojnë rrethana të tjera që pengojnë transferimin e tij ose saj në territorin e Palës Kërkuese.
3. Personi i transferuar vazhdon të qëndrojë në paraburgim në territorin e Palës Kërkuese, përveç nëse Pala e Kërkuar kërkon lirimin e tij.
4. Personit të transferuar i llogaritet koha e kaluar në paraburgim në Palën Kërkuese në kohëzgjatjen e dënimit të shqiptuar në Palën e Kërkuar.

Neni 18
Dëgjimi përmes video-konferencës

1. Nëse një person ndodhet në territorin e njëres Palë Kontraktuese dhe duhet të dëgjohet si dëshmitar ose ekspert nga autoritetet gjyqësore të Palës tjetër Kontraktuese, kjo e fundit mund të kërkojë që dëgjimi të bëhet përmes video-konferencës, siç parashihet në paragrafët 2 deri në 6 të këtij neni, nëse paraqitja fizike e personit që do të dëgjohet, në territorin e shtetit tjetër, është e papërshtatshme ose e pamundur.
2. Pala e Kërkuar pranon dëgjimin përmes video-konferencës me kusht që përdorimi i video-konferencës të mos jetë në kundërshtim me parimet e saj themelore. Nëse Pala e Kërkuar nuk ka qasje në mjete teknike për video-konferencë, këto mjete mund t'i vihen në dispozicion nga Pala Kërkuese me marrëveshje ndërmjet tyre.
3. Autoriteti gjyqësor i Palës së Kërkuar fton personin në fjalë për t'u paraqitur në përputhje me mënyrën e përcaktuar nga ligji i tij.
4. Në lidhje me dëgjimin përmes video-konferencës, vlejnjë rregullat si vijon:
 - a) Një autoritet gjyqësor i Palës së Kërkuar duhet të jetë i pranishëm gjatë dëgjimit, nëse është e nevojshme, me ndihmën e përkthyesit, si dhe është gjithashtu përgjegjës për të siguruar identifikimin e personit që do të dëgjohet dhe respektimin e parimeve themelore juridike të Palës së Kërkuar. Nëse autoriteti gjyqësor i Palës së Kërkuar konsideron që gjatë dëgjimit cenohen parimet themelore juridike të Palës së Kërkuar, atëherë merr menjëherë masat e nevojshme për të siguruar që dëgjimi të vazhdojë në përputhje me ato parime;
 - b) Kur është e nevojshme, masa për mbrojtjen e personit që dëgjohet dakordohen në mes të autoriteteve kompetente të Palës Kërkuese dhe të Kërkuar;
 - c) Dëgjimi zhvillohet drejtpërdrejt nga ose nën drejtimin e autoritetit gjyqësor të Palës Kërkuese në përputhje me ligjin e saj;
 - d) Me kërkesën e Palës Kërkuese ose të personit që dëgjohet, duhet të sigurohet ndihma e përkthyesit për personin që dëgjohet, nëse është e nevojshme;
 - e) Personi që do të dëgjohet, mund ta shfrytëzojë të drejtën e tij për të refuzuar të dëshmojë, kur kjo e drejtë i takon sipas ligjit të Palës së Kërkuar ose të Palës Kërkuese.
5. Pa paragjykuar çfarëdo mase të dakorduar për mbrojtjen e personave, autoriteti gjyqësor i Palës së Kërkuar, pas seancës dëgjimore harton një procesverbal që përmban datën dhe vendin e seancës, identitetin e personit që është dëgjuar, identitetet dhe funksionet e personave të tjerë pjesëmarrës në seancën e zhvilluar në Palën e Kërkuar, çdo betim të dhënë dhe kushtet teknike në të cilat u zhvillua seanca. Ky dokument i përcillet autoritetit kompetent të Palës Kërkuese nga autoriteti kompetent i Palës së Kërkuar.

6. Secila Palë Kontraktuese ndërmer masat e nevojshme për të siguruar që kur dëshmitarët ose ekspertët dëgjohen në territorin e tyre në përputhje me këtë nen dhe refuzojnë të dëshmojnë kur kanë obligim të dëshmojnë ose nuk japin dëshmi të vërtetë, ligji i saj i brendshëm zbatohet në të njëjtën mënyrë sikur dëgjimi të ishte zhvilluar në kuadër të një procedure të brendshme.
7. Secila Palë Kontraktuese, në diskrecion, mund të zbatojë dispozitat e këtij neni, kur është e përshtatshme dhe me marrëveshje me autoritetin e vet gjyqësor kompetent, për dëgjimin përmes video-konferencës të personit të pandehur ose të dyshuar. Në atë rast, vendimi për të zhvilluar video-konferencë dhe mënyra e zhvillimit të saj, dakordohet në mes të Palëve Kontraktuese në përputhje me ligjet e tyre të brendshme dhe instrumentet ndërkombëtare përkatëse, duke përfshirë Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike të 16 dhjetorit 1966. Dëgjimet që përfshijë personin e pandehur ose të dyshuar mund të zhvillohen vetëm me pëlqimin e tyre.

Neni 19

Dosjet gjyqësore, të autoriteteve të ndjekjes dhe hetimore

1. Sipas kërkesës, Pala e Kërkuar ua vë në dispozicion autoriteteve të Palës Kërkuese dosjet e saj gjyqësore, të organeve të ndjekjes penale dhe hetimore, duke përfshirë aktgjykimet dhe aktvendimet, nëse këto dokumente janë të rëndësishme për një proces gjyqësor.
2. Dokumentet, dosjet dhe materialet tjera dorëzohen vetëm nëse ndërlidhen me një çështje të mbyllur. Nëse çështja nuk është mbyllur, autoriteti kompetent i Palës së Kërkuar vlerëson nëse kjo është e lejueshme.

Neni 20

Dosjet gjyqësore dhe shkëmbimi i informatave

1. Pala e Kërkuar dërgon ekstrakte dhe informata në lidhje me dosjet gjyqësore, të cilat kërkohen nga autoritetet gjyqësore të Palës Kërkuese dhe që nevojiten në një çështje penale, për aq sa lejohet nga ligji i saj i brendshëm.
2. Në çdo rast të ndryshëm nga ai i parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni, kërkesa do të përmbushet në përputhje me kushtet e parashikuara me ligjin, rregulloret ose praktikën e Palës së Kërkuar.
3. Palët Kontraktuese, në përputhje me ligjet e tyre të brendshme përkatëse, i ofrojnë njëra tjetrës informata për të gjitha dënimet penale dhe masat e mëvonshme të regjistruara në dosjet gjyqësore lidhur me shtetasit e Palës tjetër Kontraktuese, edhe pa kërkesë nga ajo Palë Kontraktuese.

Neni 21

Dërgimi i sendeve, dokumenteve, dosjeve ose provave

1. Sipas kërkesës, Pala e Kërkuar i dërgon Palës Kërkuese sende, dokumente, dosje ose prova.
2. Pala e Kërkuar mund të dërgojë kopje të dokumenteve, të dosjeve ose provave të kërkuara. Nëse Pala Kërkuese kërkon shprehimisht dërgimin e origjinaleve, Pala e Kërkuar do të bëjë çdo përpjekje për ta përmbushur kërkesën.
3. Palës Kërkuese i kërkohet t'i kthejë ato që i janë dërguar sa më shpejtë që të jetë e mundur, ose më së voni pas përfundimit të procedurës, përveç kur Pala e Kërkuar heq dorë shprehimisht nga kthimi i tyre.
4. Të drejtat e pretenduara nga palët e treta ndaj sendeve, dokumenteve, dosjeve ose provave në Palën e Kërkuar, nuk pengojnë dërgimin e tyre tek Pala Kërkuese.
5. Dërgimi i sendeve, dokumenteve, dosjeve ose provave të përcaktuara në këtë nen, mund të shtyhet kur materialet e tilla nevojiten në Palën e Kërkuar për një procedurë penale në zhvillim e sipër.

Neni 22

Dorëzimi i sendeve dhe pasurisë

1. Sendet dhe pasuria që përbëjnë produkte ose përfitime nga një veprë penale të ndjekur penalisht nga Pala Kërkuese dhe instrumentet që kanë shërbyer për kryerjen e veprës penale, e të cilat i nënshtrohen një sekuestrimi paraprak ose zëvendësimit të vlerës së tyre, mund t'i dorëzohen Palës Kërkuese për qëllim të konfiskimit ose kthimit tek personi titullar, kushtëzuar nga të drejtat e palëve të treta me mirëbesim.
2. Dorëzimi mund të bëhet në çdo fazë të procedurës së huaj, bazuar në një vendim përfundimtar dhe të ekzekutueshëm të Palës Kërkuese.

Neni 23

Sekuestrimi dhe konfiskimi

1. Kërkesat për sekuestrim dhe konfiskim do të bëhen nga autoriteti kompetent sipas ligjit të brendshëm të Palës Kërkuese.
2. Dërgimi i pasurisë, dokumenteve, dosjeve ose provave të konfiskuara të përcaktuara në këtë nen, mund të shtyhet kur këto materiale nevojiten në Palën e Kërkuar për një procedurë penale në zhvillim e sipër.

3. Paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni nuk lejohet t'i cenojnë interesat legjitime të palëve të interesuara, duke përfshirë administruesit në lidhje me pasuritë e konfiskuara.

Neni 24

Ndarja e pasurisë së konfiskuar

1. Palët Kontraktuese marrin përsipër t'i ofrojnë njëra-tjetrës bashkëpunimin më të gjerë në çështjet e ndarjes së pasurisë së konfiskuar, sipas ligjeve të tyre të brendshme.
2. Për të ndarë pasurinë e konfiskuar në kuptim të këtij neni, Palët Kontraktuese lidhin marrëveshje të veçantë për çdo rast individual, ku përcaktohen kushtet e veçanta për kërkesën, dorëzimin dhe transferimin e pasurive të përbashkëta.

Neni 25

Shërbimi i dokumenteve dhe të dhënave të vendimeve gjyqësore

1. Pala e Kërkuar do të kryejë shërbimin e dokumenteve dhe vendimeve gjyqësore që i dërgohen për këtë qëllim nga Pala Kërkuese.
2. Shërbimi mund të kryhet nga Pala e Kërkuar tek marrësi me dorëzim të thjeshtë të dokumentit ose të vendimit. Nëse Pala Kërkuese kërkon shprehimisht, Pala e Kërkuar kryen shërbimin në një nga mënyrat e parashikuara sipas ligjit të saj për shërbimin e dokumenteve të ngjashme ose në mënyrë të veçantë në përputhje me atë ligj.
3. Dëshmia e shërbimit ofrohet përmes një fletë-kthese me datë dhe të nënshkruar nga personi i shërbyer, ose përmes një deklaratë të bërë nga Pala e Kërkuar se shërbimi është kryer, duke treguar formën dhe datën e shërbimit. Cilido prej këtyre dokumenteve i dërgohet menjëherë Palës Kërkuese. Nëse Pala Kërkuese e kërkon, Pala e Kërkuar, deklaron nëse shërbimi është kryer në përputhje me ligjin e Palës së Kërkuar. Nëse shërbimi nuk mund të kryhet, Palës Kërkuese i komunikohen menjëherë me shkrim arsyet.
4. Kërkesa për shërbimin e fletëthirrjes gjyqësore të një personi i ndjekur penalisht që ndodhet në territorin e Palës së Kërkuar, duhet t'i arrijë Autoritetit Qendror të kësaj Pale jo më vonë se dyzet e pesë ditë kalendarike përpara datës së caktuar për paraqitje.

Neni 26
Grupet e përbashkëta hetimore

1. Për të lehtësuar hetimet dhe ndjekjet penale, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese, me marrëveshje të ndërsjellë me shkrim, mund të mundësojnë krijimin dhe funksionimin e grupeve të përbashkëta hetimore (GPH) në territoret e tyre përkatëse, në përpulhje me konventat ndërkombëtare të ratifikuara dhe ligjet e tyre të brendshme, për një qëllim të caktuar dhe për një periudhë të kufizuar kohore.
2. Procedurat dhe kushtet sipas të cilave do të funksionojë GPH, të tilla si qëllimi, përbërja, funksionet, kohëzgjatja, vendndodhja, organizimi, mbledhja dhe përdorimi i informatave ose provave dhe kushtet e pjesëmarrjes së anëtarëve të grupit të një Pale Kontraktuese në aktivitetet hetimore që zhvillohen në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, përcaktohen ndërmjet autoriteteve kompetente në një marrëveshje të veçantë për GPH.
3. Një kopje e marrëveshjes për GPH do t'i dërgohet Zyrës Federale të Drejtësisë në Zvicër dhe Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit në Republikën e Kosovës.

KAPITULLI IV - PROCEDURA

Neni 27
Autoriteti Qendror

1. Për qëllimet e këtij Traktati, Autoriteti Qendror për Zvicrën është Zyra Federale e Drejtësisë e Departamentit Federal të Drejtësisë dhe Policisë dhe për Republikën e Kosovës, Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar i Ministrisë së Drejtësisë.
2. Autoritetet Qendrore paraqesin kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet penale të mbuluara nga ky Traktat në emër të autoriteteve të tyre kompetente dhe pranojnë kërkesat e parashtruara nga Pala tjetër Kontraktuese.
3. Autoriteti Qendror i Palës së Kërkuar trajton kërkesat për ndihmë të ndërsjellë juridike sa më shpejtë që të jetë e mundur dhe aty ku është e zbatueshme, ia dërgon ato për ekzekutim autoriteteve të veta kompetente. Autoriteti Qendror koordinon zbatimin e këtyre kërkesave.
4. Autoritetet Qendrore të Palëve Kontraktuese komunikojnë drejtpërdrejt me njëra-tjetrën.

5. Autoritetet Qendrore të Palëve Kontraktuese mund të komunikojnë në anglisht.
6. Secila Palë Kontraktuese mund ta ndryshojë Autoritetin e saj Qendror, me ç'rast njofton me shkrim përmes kanaleve diplomatike.

Neni 28

Forma e kërkesës dhe kanalet e dërgimit

1. Kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike bëhet me shkrim.
2. Në rast urgjence, kërkesa mund të dërgohet në mënyrë elektronike ose me çdo mjet tjetër të pranuar nga Pala e Kërkuar. Origjinali i kërkesës dërgohet sa më shpejt që të jetë e mundur nga Pala Kërkuese.

Neni 29

Përmbajtja e kërkesës

1. Kërkesa duhet të përmbajë:
 - a) emrin e autoritetit që zhvillon hetimin, ndjekjen penale ose procedurën me të cilën lidhet kërkesa;
 - b) objektin dhe arsyen e kërkesës;
 - c) një përshkrim të detajuar të provave, informatave ose masave të kërkuara;
 - d) kur është e mundur, emrin e plotë, vendin dhe datën e lindjes, shtetësinë dhe adresën aktuale të personit që është subjekt i procedurës penale;
 - e) arsyen kryesore për të cilën kërkohet prova ose informatat, si dhe një përmbledhje të fakteve të rëndësishme (data, vendi dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra) mbi bazën e të cilave është filluar procedura penale në Palën Kërkuese, përveç rasteve kur kërkesa është për shërbim të dokumenteve sipas nenit 25;
 - f) ndërlidhjen që ekziston ndërmjet fakteve që hetohen në Palën Kërkuese dhe masave që duhet të ndërmerren në Palën e Kërkuar;
 - g) tekstin e dispozitave ligjore, ose kur kjo nuk është e mundur, një deklaratë rreth ligjit përkatës të zbatueshëm;
 - h) shkallën e kërkuar të konfidencialitetit dhe arsyet për këtë;
 - i) çfarëdo afati kohor brenda të cilit kërkohet ekzekutimi i kërkesës; dhe
 - j) informata ose veprime të tjera që mund të kërkohen sipas ligjit të brendshëm të Palës Kërkuese ose që janë të nevojshme për ekzekutimin e rregullt të kërkesës.

2. Kërkesa duhet të përmbajë edhe:

- a) në rastin e zbatimit të ligjit të huaj në lidhje me ekzekutimin (neni 5, paragrafi 2), tekstin e dispozitave që janë të zbatueshme në Palën Kërkuese dhe arsyen e zbatimit të tyre;
 - b) në rastin e pjesëmarrjes së personave në procedurë (neni 11), emrin e personit që është i pranishëm në ekzekutimin e kërkesës dhe arsyen e pranisë së tij;
 - c) vendin e mundshëm dhe një përshkrim të sendeve dhe pasurisë që paraqesin produktin e një veprë penale ose të ardhurave prej saj, ose instrumentet që kanë shërbyer për kryerjen e veprës penale, ose arsyen kryesore pse këto sende dhe pasuri supozohet se ndodhen në territorin e Palës së Kërkuar (nenet 22 dhe 23);
 - d) në rastin e shërbimit të dokumenteve dhe të dhënave të vendimeve gjyqësore dhe të fletëhirrjes gjyqësore (neni 13 dhe neni 25), emrin dhe adresën e personit për t'u shërbyer;
 - e) në rastin kur ftohen dëshmitarë ose ekspertë (neni 13), një deklaratë që Pala Kërkuese do t'i paguajë shpenzimet dhe mëditjet dhe se, nëse i kërkohet, do t'i parapaguajë ato;
 - f) në rastin e transferimit të përkohshëm të personave të ndaluar (neni 17), emrat e tyre, të dhënat e zyrtarëve nën kujdestarinë e të cilëve gjendet personi i ndaluar gjatë transferimit nëse ka të tillë, vendin ku duhet të transferohet personi i ndaluar, si dhe kohën e mundshme të kthimit;
 - g) në rastin e dëgjimit me video-konferencë (neni 18), arsyen pse nuk është e përshtatshme apo e mundur pjesëmarrja e dëshmitarit apo ekspertit, emrin e autoritetit gjyqësor dhe të personave që do ta zhvillojnë seancën;
 - h) në rastin e marrjes në pyetje të dëshmitarëve (neni 12, neni 13 dhe neni 17), temën në lidhje me të cilën duhet të dëgjohet personi, duke përfshirë, nëse është e nevojshme, një listë të pyetjeve që duhen bërë dhe një përshkrim të dokumenteve, dosjeve ose provave që do të sigurohen;
 - i) në rastin e dorëzimit të sendeve ose pasurisë për konfiskim ose kthim personit që i takojnë (nenet 22 dhe 23), vendimin e plotfuqishëm të gjykatës, nëse ka të tillë dhe një deklaratë për statusin e atij vendimi;
 - j) çfarëdo informate, prove ose dokumenti tjetër mbështetës që është i nevojshëm për të mundësuar ose që mund të ndihmojë Palën e Kërkuar të ekzekutojë kërkesën.
3. Nëse Pala e Kërkuar konsideron se informatat nuk janë të mjaftueshëm për ta ekzekutuar kërkesën, ajo mund të kërkojë informata shtesë për t'ju mundësuar trajtimi i kërkesës.

Neni 30

Ekzekutimi i kërkesës

1. Varësisht nga miratimi i masave të përkohshme në përputhje me nenin 7, Autoriteti Qendror i Palës së Kërkuar, do të njotojë pa vonesë Autoritetin Qendror të Palës Kërkuese nëse kërkesa nuk është në përputhje me

dispozitat e këtij Traktati dhe do të kërkojë ndryshimin ose plotësimin e kërkesës.

2. Nëse kërkesa duket se është në përputhje me këtë Traktat, Autoriteti Qendror i Palës së Kërkuar ia përcjell atë menjëherë autoritetit kompetent për ekzekutimin e saj.
3. Pasi që të jetë ekzekutuar kërkesa, autoriteti kompetent ia përcjell Autoritetit Qendror të Palës së Kërkuar, kërkesën, informatat dhe provat e mbledhura. Autoriteti Qendror është përgjegjës të sigurojë që ekzekutimi të jetë i plotë dhe ia komunikon rezultatet e ekzekutimit Autoritetit Qendror të Palës Kërkuese.
4. Paragrafi 3 i këtij neni nuk pengon ekzekutimin e pjeshëm të kërkesës.
5. Pala e Kërkuar e njofton menjëherë Palën Kërkuese për vendimin e saj për të mos përmbushur plotësisht ose pjesërisht kërkesën për ndihmë ose për çdo rrethanë që ka mundësi të shkaktojë një vonesë të ndjeshme në përgjigjen e kërkesës.

Neni 31

Përrjashtimi nga legalizimi, vërtetimi dhe kërkesat tjera formale

1. Të gjitha dokumentet, dosjet, deklaratat dhe materialet tjera të dërguara në përputhje me këtë Traktat, përjashtohen nga çdo kërkesë legalizimi, vërtetimi dhe formaliteti.
2. Dokumentet, dosjet, deklaratat dhe materialet e dërguara nga Autoriteti Qendror i Palës së Kërkuar pranohen si prova pa arsytim të mëtejshëm ose dëshmi origjinaliteti.

Neni 32

Gjuha

1. Kërkesat e parashtruara nga Zvicra në përputhje me këtë Traktat dhe dokumentet shoqëruese, përkthehen në njërën nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës (shqip ose serbisht). Kërkesa e parashtruar nga Republika e Kosovës në përputhje me këtë Traktat dhe dokumentet shoqëruese, përkthehen në njërën nga gjuhët zyrtare të Zvicrës (frëngjisht, gjermanisht ose italisht), siç theksohet në secilin rast nga Autoriteti Qendror Zviceran.
2. Pala Kërkuese obligohet për përkthimin e dokumenteve nga ekzekutimi i kërkesës.
3. Çdo përkthim i kryer nga Palët Kontraktuese është i natyrës zyrtare.

4. Në raste urgjente dhe kur dakordohen Autoritetet Qendrore, kërkesat dhe dokumentet mbështetëse mund të dërgohen fillimisht në gjuhën angleze.

Neni 33

Shpenzimet që lidhen me ekzekutimin e kërkesës

1. Me kërkesë të Palës së Kërkuar, Pala Kërkuuese rimbursion vetëm shpenzimet si në vijim, të bëra gjatë ekzekutimit të një kërkesë:
 - a) mëditjet, shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për dëshmitarët dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë, nëse ka;
 - b) shpenzimet që lidhen me transferimin e personave të ndaluar;
 - c) tarifatat, shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për ekspertët;
 - d) përveç nëse Palët Kontraktuese pajtohen ndryshe, shpenzimet në lidhje me dëgjimin përmes video-konferencës sipas nenit 18, shpenzimet për krijimin e video-lidhjes në Palën e Kërkuar, pagesën e përkthyesve të siguruar nga ta dhe mëditjet e dëshmitarëve dhe ekspertëve, si dhe shpenzimet e udhëtimit të tyre në Palën e Kërkuar;
 - e) përveç nëse Palët Kontraktuese pajtohen ndryshe, shpenzimet që lidhen me zbatimin e masave të fshehta të vëzhgimit.
2. Nëse ekzekutimi i kërkesës shkakton shpenzime të jashtëzakonshme, Pala e Kërkuar e njofton Palën Kërkuuese për këtë për të përcaktuar kushtet sipas të cilave mund të ofrohet ndihma e kërkuar.

KAPITULLI V - SHKËMBIMI SPONTAN DHE OFRIMI I INFORMATAVE PËR QËLLIM TË NDJEKJES PENALE OSE KONFISKIMIT

Neni 34

Shkëmbimi spontan i informatave ose provave

1. Nëpërmjet kanalit të Autoritetit të vet Qendror dhe brenda kufijve të ligjit të tij të brendshëm, një autoritet kompetent i njërës Palë Kontraktuese, pa kërkesë paraprake, mund t'i dërgojë Autoritetit Qendror të Palës tjetër Kontraktuese informata ose prova të mbledhura gjatë hetimit apo ndjekjes penale që ka zhvilluar, kur konstaton se dërgimi është i natyrës së atillë që:
 - a) mundëson paraqitjen e një kërkesë në përputhje me këtë Traktat;
 - b) mundëson hapjen e një procedure penale ose ofron informata kur Pala Kontraktuese nuk ka kompetencën për të ndjekur ose gjykuar çështjen; ose
 - c) lehtëson një hetim penal në zhvillim e sipër.

2. Autoriteti që ofron informatat, në përputhje me ligjin e vet të brendshëm, mund të vendosë kushte për përdorimin e këtyre informatave nga Pala Kontraktuese marrëse. Pala Kontraktuese marrëse duhet t'i respektojë këto kushte.

Neni 35

Ofrimi i informatave për qëllim të ndjekjes penale ose konfiskimit

1. Informatat e ofruara nga njëra Palë Kontraktuese për qëllim të ndjekjes penale në gjykatat e Palës tjetër Kontraktuese ose për qëllim të konfiskimit të të ardhurave nga krimi, komunikohet ndërmjet Autoriteteve Qendrore.
2. Autoriteti Qendror i Palës së Kërkuar do të njoftojë Palën Kërkuese për çdo veprim të ndërmarrë në lidhje me këto informata dhe ia përcjell një kopje të çfarëdo vendimit të marrë.
3. Dispozitat e nenit 32, paragrafi 1, zbatohen për informatat e ofruar sipas paragrafit 1 të këtij neni.

KAPITULLI VI - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 36

Pajtueshmëria me marrëveshjet dhe format tjera të bashkëpunimit

Dispozitat e këtij Traktati nuk ndikojnë në ndihmën e ndërsjellë juridike të mëtejme për të cilën Palët Kontraktuese kanë ose mund të jenë pajtuar sipas marrëveshjeve tjera ose që rezultojnë nga ligjet e tyre të brendshme.

Neni 37

Konsultimet

Autoritetet Qendrore do të shkëmbejnë pikëpamjet e tyre mbi zbatimin e këtij Traktati, gojarisht ose me shkrim, përgjithësisht ose për raste të veçanta, kurdo që të jetë e përshtatshme.

Neni 38

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çfarëdo mosmarrëveshje që lind rreth interpretimit, zbatimit ose zbatueshmërisë së këtij Traktati, zgjidhet përmes kanaleve diplomatike, nëse Autoritetet Qendrore nuk mund të arrijnë pajtim ndërmjet tyre.

Neni 39
Amendamenti

Ky Traktat mund të ndryshohet në çdo kohë me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve Kontraktuese. Amendamenti i tillë hyn në fuqi sipas të njëjtës procedurë që zbatohet për hyrjen në fuqi të këtij Traktati.


Neni 40
Hyrja në fuqi dhe shkëputja

1. Palët Kontraktuese e njoftojnë me shkrim njëra-tjetrën për plotësimin e kërkesave të tyre përkatëse të brendshme për hyrjen në fuqi të këtij Traktati. Traktati hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së marrjes së njoftimit të fundit.
2. Secila Palë Kontraktuese mund ta shkëpusë këtë Traktat në çdo kohë duke njoftuar me shkrim Palën tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në këtë rast, Traktati pushon së prodhuari efekt gjashtë muaj pas datës së marrjes së atij njoftimi. Shkëputja e Traktatit nuk ka asnjë efekt për rastet në zhvillim e sipër.

NË DËSHMI TË KËSAJ, të poshtë-nënshkruarit, të autorizuar nga Qeveritë përkatëse, kanë nënshkruar këtë Traktat.

NËNShKRUAR në dy kopje në Prishtinë më 5.4.2022 në gjuhën angleze, shqipe dhe gjermane, me të gjitha tekstet njësoj autentike. Në rast të mospërputhjeve në interpretim, do të mbizotërojë teksti në gjuhën angleze.

Për Republikën e Kosovës:



Për Konfederatën Zvicerane:

